

## DEPARTAMENTET E KIMISË NË 60 VJETORIN E UNIVERSITETIT TË TIRANËS

PANDELI TROJA., DHIMITËR HAXHIMIHALI., ALQI ÇULLAJ.

Të nderuar pjesëmarrës, kolegë, studentë, miq e të ftuar.

Kam nderin dhe privilegjin që në këtë 60 vjetor të krijimit të Universitetit të Tiranës të përshëndes në emër të stafit pedagogjik dhe studentëve të degëve të Kimisë.

60 vjet për një Universitet që është qendra më e madhe mësimore shkencore dhe edukative në vend, nuk janë shumë krahasuar me Universitetet Europiane që kanë vjetërsi shekullore aktiviteti mësimor e shkencor; por nuk janë edhe pak, për të treguar punën kolosale, të vazhdueshme e me cilësi të lartë që ka bërë brezi i themeluesve të këtij Institucioni, të cilët me një vizion të qartë, me këmbëngulje shëmbëllore, vunë bazat dhe piketat largpamëse të kësaj vatre të pazëvendësueshme të arsimit, shkencës dhe intelektualëve të vendit tonë.

Në vjeshtën e vitit 1957, në kuadër të krijimit të Fakultetit të Shkencave të Natyrës si një nga Fakultetet më me peshë në UT, u krijua edhe Dega e Kimisë, pjesë e këtij Fakulteti bashkë me degët e Matematikës, Fizikës dhe Biologji-Kimisë. Dega që u quajt "Kimi Industriale" u krijua si një drejtim i ri, me qëllim që të përgatiste kryesisht kadro kimistë teknologë që të drejtonin Industrinë tonë në krijim dhe të plotësonin Institucionet e reja që kishin nevojë për specialistë në fushën e Kimisë. Ashtu si degët e tjera edhe dega e Kimisë Industriale nuk lindi në një terren bosh dhe pa eksperiencë. Tanimë ishte krijuar një bazë modeste në përgatitjen e specialistëve me arsim të lartë. Që nga viti 1947 funksiononin sektorët shkencorë të Institutit të Shkencave.

Në vitin 1951 u krijua Instituti i Lartë Pedagogjik 4 vjeçar. Po ashtu ishte krijuar dhe funksiononte Laboratori i Kërkimeve Kimike që drejtohej nga Profesor Kolë Popa, një qendër e rëndësishme e kërkimit shkecor në fushën e Kimisë. Ky Laborator ishte i pajisur me një bazë të pasur materiale dhe nga më modernet për kohën. Laboratori kish sistem të mbyllur gazi, kishte një punishte të specializuar për mirëmbajtjen e pajisjeve dhe aparaturave, ku punonte duararti Niko Llaci, kishte qëndrën e punimit të qelqit që në mjaft raste plotësonte nevojat e prodhimit dhe riparimit të aparaturave të thjeshta. Kjo qendër më vonë u plotësua edhe me sektorin e pajisjeve të zmeriluara dhe në mjaft raste është përdorur edhe si laborator mësimor, ku studentët e Kimisë mësonin praktikisht disa punime të thjeshta me qelq. Në këtë laborator fillimisht kanë punuar disa nga specialistët e parë të kimisë të Fakultetit tonë. Shumë shpejt numuri i tyre u rrit me të rinj, duke u përfshirë këtu edhe studentët e vitit të fundit që kryenin

punimin e diplomës. Në këtë qëndër kanë punuar për kohë të ndryshme Profesorët Kolë Popa, Muharrem Frashëri, Vasil Bilushi, Viron Kola, Petro Koçi, Theano Shteto, Kostë Koci, Pandeli Troja, Genc Damani, Safo Frashëri, etj. Mbi bazën e kësaj trashëgimie u krijua Dega e Kimisë Industriale, fillimisht 4 vjeçare, me tre Katedra: Katedra e Kimisë së përgjithëshme dhe Inorganike me drejtues Profesor Menella Karajani, Katedra e Kimisë Organike me drejtues Profesor Kolë Popa dhe Katedra e Kimisë Analitike dhe Teknologjisë, me drejtues Profesor Muharrem Frashëri.

Në tre katedrat e Kimisë Industriale pedagogët që jepnin mësim nuk e kalonin shifrën 10, duke përfshire këtu edhe 2-3 pedagogë të jashtëm. Vlen të theksohet se Pedagogët e parë kishin studiuar pothuaj të gjithë jashtë vendit dhe kryesisht në Universitetet perëndimore dhe dalloheshin për nivel të lartë shkencor e kulturor, mësimdhënie cilësore dhe për përkushtim dhe saktësi në punën e tyre. Në atë kohë vetëm 2 pedagogë të huaj kanë dhënë mësim në degën tonë: Profeshori i Universitetit të Moskës V. Lebedjev që jepte leksionet e Kimisë Fizike dhe Taisa Pisha që ka drejtuar seancat laboratorike të Kimisë Organike. Një kontribut të veçantë kanë dhënë si pedagogë të jashtëm kimistë që kishin kryer Universitetet në Europë dhe drejtonin Institucione të rëndësishme në vend. Të tillë ishin figurat e shquara të shkencës së kimisë, Profesorët Islam Rusi dhe Ernest Bushati, që në periudhën 1959-1968 kanë dhënë me një profesionalizëm të shquar lëndën e Kimisë Analitike dhe Teknologjinë Kimike. Më vonë si pedagogë të jashtëm janë aktivizuar edhe kimistë të tjerë të shquar si Lirim Selfo, Gazmend Gjyli, etj.

Fillimisht dhe për disa vite rrjesht Dega e Kimisë Industriale e zhvillonte aktivitetin mësimor-shkencor në godinën ku sot të është Biblioteka dhe Rektorati i Universitetit të Tiranës. Aty u sistemuan disa dhoma si laboratore, dy salla leksionesh dhe disa anekse preparatore të vogla. Dega e Kimisë Industriale e filloi aktiivitetin e saj në 1957 me 14 studentë. Brezi i dytë, të cilit i përkasim unë dhe profesorët Dhimitër Haxhimihali dhe Roland Pinguli, kishte 25 studentë. Pas katër vjetëve numuri i studentëve shkoi në 100. Me kalimin e viteve numuri i studentëve u rrit. Mbarëvajtja e punës diktoi nevojën e riorganizmit të Degës. Kështu u formuan disa katedra të reja si ajo e Kimisë Analitike me drejtues Prof. Feti Sazani, ajo e teknologjisë Kimike dhe Merceologjisë (kjo e fundit e ndërtuar rishtaz) me drejtues Prof. Muharrem Frashëri si dhe ajo e Kimisë Fizike e Koloidale me drejtuese Prof. Semiramis Alia.

Në vitet 1967-1968 u bë një punë shumë e madhe për rinovimin e kurrikulave mësimore, për krijimin e mjediseve të reja mësimore e shkencore, për përgatitjen e teksteve mësimore, kryesisht adaptime dhe përkthime. Këto i paraprinë me sukses kalimit nga sistemi arsimor 4 vjeçar në atë 5 vjeçar. Transferimi i Fakultetit si dhe degës së Kimisë Industriale në mjediset ku jemi edhe sot, krijoi kushte më të mira dhe mjedise më të kompletuara. Katedrat ekzistuese u

sistemuan pothuaj të gjitha në gjysmën e çdo kati të godinës A. Si rezultat i kërkesave gjithmonë në rritje për kimistë, në shumë sektorë të ekonomisë, në vitin 1969 u hap dhe filloi mësimi edhe në degën e sistemit të mbrëmjes, ku i'u dha mundësia të diplomoheshin shumë studentëve që punonin në industri, laboratorët e prodhimit dhe laborantë.

Fluksit të studentëve që u kthyen nga studimet jashtë shtetit me prishjen e marrëdhënive me vendet ku ata studionin, iu krijua mundësia që të likuidonin detyrimet e prapambetura dhe të finalizonin me sukses studimet.

Në përgjigje të nevojave të ngutëshme të industrisë së përpunimit të naftës dhe gazit u hap dhe funksionoi për disa vite dega e Teknologjisë së Naftës dhe Gazit, e cila me specialistët që përgatiti, dha një kontribut jo të vogël në ngritjen dhe funksionimin e Kombinatit të Përpunimit të Thellë të Naftës dhe Gazit në Ballsh.

Pedagogët dhe punonjësit ndihmës të kësaj dege vazhdimisht kanë kontribuar në përgatitjen e specialistëve të profileve të tjera nëpërmjet zhvillimit të mësimëve për lëndët bazë në Fakultete e tjera. Kështu lëndët si Kimia e Përgjithëshme dhe Inorganike, Kimia Organike, Kimia Analitike, Kimia Fizike dhe Koloidale, Kimia dhe Teknologjia e Ushqimeve, Metodatat Instrumentale të Analizës i kanë zhvilluar me nivel të lartë pedagogët e katedrave të Kimisë në degët e Mjekësisë së Përgjithëshme, Farmacisë, Stomatologjisë, Merceologjisë, etj. Edhe sot disa nga këto lëndë formimi bazë vazhdojnë të mbulohen nga ky Fakultet. Edhe në Fakultetet e Inxhinierisë lëndët formuese në disa degë janë zhvilluar nga pedagogët tanë.

Pas vitit 1990, si rrjedhojë e zhvillimeve të reja politike, ekonomike, sociale e arsimore, doli e nevojshme të kryhej në Universitetin e Tiranës, tashmë të ndarë nga Universiteti Politeknik, një reformë e re, e kohës dhe e gjithanshme. Kështu në vitin akademik 1990-1991 dega e Kimisë Industriale u nda në tre drejtime studimore që kanë funksionuar si degë me diploma të veçanta: Dega e Kimisë, Dega e Kimisë Ushqimore, Dega e Kimisë Industriale dhe Mjedisore. Ky organizim funksiononte me njësi bazë katedrat që vareshin direkt nga Dekani, i cili për kohën emërohej.

Katedrat u ngritën në bazë të lëndëve themelore dhe të përafërta. Kështu u krijuan 8 Katedra me drejtuesit e tyre:

- Katedra e Kimisë së Përgjithëshme dhe Inorganike, drejtuar nga Profesorët Menella Karajani, Kastriot Spahiu, Mihal Prifti.
- Katedra e Kimisë Organike, drejtuar nga Profesorët Kolë Popa, Maruf Haxhimusaj, Kostë Koci, Pandeli Troja, Genc Damani.
- Katedra e Kimisë Fizike dhe Koloidale, drejtuar nga Profesorët Semiramis Alia, Viron Kola, Fatos Adami, Ilo Mele, Marita Koroveshi.

- Katedra e Kimisë Analitike, drejtuar nga Profesorët Feti Sazani, Alqi Cullaj, Besnik Baraj, Odeta Kati, Pranvera Lazo.
- Katedra e Teknologjisë Kimike drejtuar nga Profesorët Hajri Haxhi, Dhimitër Haxhimihali.
- Katedra e Proceseve dhe Aparateve, më vonë e Inxhinierisë Kimike drejtuar nga Profesorët Eduard Plasari, Ilirjan Malollari.
- Katedra e Kimisë dhe Teknologjisë së Ushqimeve drejtuar nga Profesorët Muharrem Frashëri, Donika Prifti, Rozana Troja.
- Katedra e Teknologjisë Kimike Organike (pas ndarjes së Teknologjisë Kimike) drejtuar nga Profesorët Rolanda Dhimitri, Agim Malja.

•  
Që nga viti 1994 e në vazhdim u bë organizimi me Departamente dhe Seksione. Sot ka dy Departamente: Departamenti i Kimisë dhe Departamenti i Kimisë Industriale.

Departamenti i Kimisë përbëhet nga seksionet e Kimisë së Përgjithëshme, Kimisë Organike, Kimisë Fizike e Koloidale dhe Kimisë Analitike. Ky Departament sot ka degën e Kimisë si dhe mbulon lëndët kimike bazë edhe në Departamentet e tjera të FSHN. Fillimisht Departamenti u drejtua nga Kryetari i Këshillit të Degëve Profesor Alqi Çullaj; më pas nga Profesorët Kostë Koci, Pandeli Troja, Eduard Andoni dhe sot Prof. Kozeta Vaso.

Departamenti i Kimisë Industriale përbëhet nga seksioni i Kimisë, Teknologjisë e Mikrobiologjisë Ushqimore, seksioni i Kimisë Industriale dhe ai i Inxhinierisë Kimike. Departamenti është drejtuar nga Profesorët Elmaz Shehu, Spiro Drushku dhe sot Prof. Rozana Troja.

Pas vitit 2005 me kartën e Bolonjës në Departamentin e Kimisë Industriale u bë organizimi në 2 Cikle studimore: Cikli i parë Bachelor-diplomë tre vjecare në Kimi Industriale dhe Mjedisore si dhe Bachelor në Kimi dhe Teknologji Ushqimore. Cikli i dytë i studimeve Master i Shkencave-studime 2 vjeçare dhe diplomë në Inxhinieri e Proceseve Kimike, në Shkencat dhe Teknologjitë Ushqimore, si dhe në Kimi Industriale dhe Mjedisore. Këto studime të ciklit të dytë janë pasuar nga studimet në ciklin e tretë të studimeve të doktoraturës (Shkolla e Doktoraturës e Departamentit Kimi Industriale me tre drejtime)

Me të njëjtin organizmi pas 2005, në Departamentin e Kimisë ka 2 Cikle studimore, për ciklin e parë tre vjecar të studimit jepet diplomë Bachelor në Kimi, për ciklin e dytë diplomë e nivelit të dytë Master i Shkencave në Kimi - drejtimi Analizat Kimike dhe Vetitë e Lëndës dhe Master i Shkencave në Kimi AML. Edhe në këtë Departament studimet vazhdojnë më ciklin e tretë të Doktoraturave.

Vlen të përmendet që në periudhën 2000-2008 pranë Departamenteve të Kimisë dhe Kimisë Industriale kanë zhvilluar aktivitetin 2 shkolla pasuniversitare, finalizuar me diploma të studimeve Master i Nivelit të Dytë: Departamenti i Kimisë në drejtimet Analiza Kimike dhe Identifikimi i Strukturës me Metodën Instrumentale si dhe Elektrokimia e Proçeseve të Korozionit; Departamenti i Kimisë Industriale në drejtimet Inxhinieri e Proçeseve Kimike, Inxhinieri Ushqimore si dhe Kimi Industriale.

Zhvillimi i kërkimit shkencor në Departamentet tona ka qënë një nga obligimet kryesorë dhe i vazhdueshëm. Ky aktivitet është zhvilluar me qëllim realizimin e dy pikësnyimeve bazë:

- t'i shërbejë kualifikimit të mëtëjshëm shkencor dhe didaktik të pedagogëve.
- të ndikojë në mënyrë modeste në problemet e zhvillimit ekonomik të vendit.

Fillimisht një numër shumë i vogël pedagogësh patën mundësinë të specializohen e të kryejnë aktivitet kërkimor shkencor në disa vende të Europës. Pas viteve 1990 u mundësua specializimi i një numëri shumë të madh pedagogësh në Universitete prestigjioze në Europë, SHBA e në botë. Sot pothuaj të gjithë janë kualifikuar jashtë mundësuar nga Programe Ndërkombëtare, fillimisht nga UNESCO, më pas TEMPUS, DAAD, INTERREG, Aria di Confini, Protokolle të Bashkëpunimit Dypalësh, ERASMUS, etj. Publikimet me faktor impact dhe indekse të tjerë, në revistat shkencore brenda dhe jashtë vendit, puna më projekte të përbashkëta, të financuara nga programet më sipër, pjesëmarrja në Konferenca e Kongrese Ndërkombëtare me emër, anëtarësimi në Shoqatat Ballkanike, Europiane dhe më gjërë, janë pasqyrim i punës serioze dhe kërkimit shkencor bashkëkohor në Departamente.

Dega e Kimisë, në fillim kish një numër të kufizuar studentësh dhe pedagogësh. Sot, në të dy Departamentet, vetëm në vitin shkollor 2017-2018 ka të regjistruar 300 studentë në ciklin e parë dhe 200 studentë në ciklin e dytë. Aktualisht zhvillojnë aktivitet mësimor e shkencor 46 pedagogë të brëndshëm dhe mbi 40 pedagogë të jashtëm, si dhe 20 punonjës ndihmës mësimorë, edhe këta me arsim të lartë dhe një pjesë e tyre edhe me Master të nivelit të dytë. Nga stafi akademik i brëndshëm 13 pedagogë kanë titullin Profesor, 11 Profesor i asocijuar, 16 kanë gradën Doktor dhe 6 Master, që kanë ardhur vitet e fundit dhe janë në proçes të kryerjes së doktoraturës. Numuri i doktorantëve të viteve të fundit është shumë i madh. Vetëm në vitin 2016 kanë mbrojtur me sukses doktoratën në të dy Departamentet tona 15 kandidatë. Vlen të theksohet se tanimë në kryerjen e doktoraturës angazhohen jo vetem nga stafi akademik i shkollave të larta por edhe nga Institucionet e tjera. Po ashtu është rritur ndjeshëm edhe numuri i pedagogëve që kanë aplikuar dhe fituar titujt akademikë Docent, Profesor i

asocijuar, Profesor dhe Akademik. Është nder dhe sukses për Departamentet e Kimisë që prej tyre kanë dalë Akademikë me kontribut të veçantë si Profesorët Kolë Popa, Dhimitër Haxhimihali, Ilirjan Malollari dhe Arben Markoçi, ish pedagogu ynë që sot është Profesor me aktivitet të spikatur në Spanjë.

Me konsiderata të veçanta për punën e tyre të palodhur, me nivel të lartë e devocion të respektueshëm, për shumë vite, ne duhet të përmendim figura dinjitoze të mësimdhënies dhe shkencës, që do të respektohen e nderohen gjithmonë. Të tillë janë Profesorët Menella Karajani, Muharrem Frashëri, Hilmi Binbashi, Hajri Haxhi, Rolanda Dhimitri, Eduard Plasari, Petrit Dodbiba, Niko Dhamo, Agim Malja, Elmaz Shehu, Donika Prifti, Jozefita Marku, Viron Kola, Kristaq Qirjako, Kostë Koci, Rexhep Shpati, Mihallaq Shkurti, Sami Meqemeja, Kastriot Spahiu, Zyhdi Zekja, Feti Sazani, Niko Laço-një ndër shkencëtarët themelues të Kimisë Analitike, Islam Rusi - figurë e ndritur e Kimisë në Shqipëri, Alqi Çullaj, Naum Xhillari, Elisabeta Noga, Mehmet Shijaku, Marjana Demirxhi, Sali Bollati, Sefer Matja, Odeta Kati, Argjirulla Cabej, Filip Lubonja, Daut Vezi, Semiramis Alija, Sofokli Ndini, Gani Xhaja, Fatos Adami, Marita Nake, Hasan Karagjozi, Besnik Sykja-student e pedagog i talentuar, Ilo Mele, Maruf Haxhimusaj, Genc Damani, Theano Shteto, Gjergji Sini, Edmond Biba dhe të tjerë.

Ndër vite, kësaj plejade me shumë eksperiencë, i janë shtuar studentë të shkëlqyer të degëve të Kimisë, që megjithëse më të rinj, sot janë lektorë të spikatur dhe kërkues shkencorë të talentuar e të palodhur. Ata janë në këtë Konferencë dhe me praninë e tyre në grupin organizues e bordin shkencor si dhe me publikimet e paraqitura, i bëjnë nder Departamenteve të Kimisë, Fakultetit dhe Universitetit tonë.

Shumë pedagogë të tjerë, më të rinj në moshë që kontribuan pranë këtyre Departamenteve, qoftë edhe për kohë të shkurtër, sot punojnë me përkushtim dhe sukses në Departamente dhe Institucione analoge brënda dhe jashtë vendit. Duhet theksuar që pedagogë të Departamenteve tona janë shquar jo vetëm në fushën e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor por edhe në detyra të rëndësishme shtetërore e me përgjegjësi. Nga Departamentet tona janë zgjedhur Zv Rektorë Profesorët Muharrem Frashëri e Rolanda Dhimitri; Dekanë Profesorët Kolë Popa- dekan i më jetë gjatë, 16 vjet në detyrë, Semiramis Alia, Ilir Malollari, Spiro Drushku; zv Dekanë Maruf Haxhimusaj, Kristaq Qirjako, Alqi Cullaj, Pandeli Troja, Ilo Mele, Marita Nake, Altin Mele, Majlinda Vasjari.

Nuk duhet lënë pa përmendur fakti që pedagogë, por edhe ish studentë të degëve të Kimisë, në sajë të kulturës dhe dijeve universale marrë në Fakultet, kanë merituar plotësisht dhe janë shquar në detyra e funksione të rëndësishme si Deputetë të Kuvendit Popullor, Drejtues të Institucioneve, Drejtorë Drejtorish, Titullarë në Përfaqësi Diplomatike, Ministra, zv Ministra e deri Kryeministër.

Kontributi dhe bashkëpunimi i Profesorëve të Departamenteve tona Kolë Popa, Feti Sazani, Viron Kola, Kostë Koci, Pandeli Troja, Maruf Haxhimusaj, Elisabeta Noga, etj. me Universitetin e Prishtinës, Universitetin e Mitrovicës dhe atë të Tetovës përbën një dimension më vehte e me vlera afatgjata për arsimin dhe shkencën shqiptare. Akoma dhe sot në këto Universitete kujtohen me respekt dhe mall leksionet e pedagogëve të Fakultetit të Shkencave të Natyrës. Bashkëpunimi sot vazhdon me sukses me leksione, punime të përbashkëta shkencore, botime e publikime të përbashkëta, udhëheqje mikrotezash e doktoraturash, oponenta, pjesmarrje në komisione mbrojtjeje e juri, etj. Bashkëpunimi në mësimdhënie dhe shkencë është forcuar e zgjeruar edhe me Universitete të tjera me emër në Europë e më tej.

Sa u përmendën më sipër janë një pjesë e vogël e atij aktiviteti shumëvjeçar të dy Departamenteve. Kjo përvojë 60 vjeçare duhet të mbahet mirë parasysh dhe të vlerësohet pa kaluar në vetkënaqësi, por me objektivitet dhe i takon të rinjve që në këtë situatë të favorshme të çojnë përpara e të ngrenë më lart nivelin didaktik, shkencor dhe edukues të kësaj qendre të madhe dhe të pazëvendësueshme të dijes.